



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 114

Prishtinë, më 24.5.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj, Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.5.2013,
3. Shqyrtimi i hartimit të Projektligjit mbi veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë,
4. Shqyrtimi i vërejtjeve dhe caktimi i grupeve punuese për Projektligjet për Planifikimin Hapësinor dhe Trajtimin e ndërtimeve pa leje,
5. Caktimi i grupeve punuese për monitorimin e Ligjeve për Pyjet, Verërat, Ajrin dhe Zhurmën.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe u shtua për “Të ndryshme” shqyrtimi i konfirmimit për leximin e dytë të “Ndërtesave në bashkëpronësi” dhe vendimi për shpalljen e konkursit për Agjencinë e Komplekseve memoriale.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.5.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.5.2013.

3. Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës bashkërisht

Kryetari Nait Hasani pasi që njoftoi shkurtimisht për vizitën në Shqipëri, për pikat në vijim konstatoi se duhet të caktohen grupet punuese, ndaj në vazhdim Komisioni u pajtua unanimisht për GP si vijon :

GP. 1. P/Ligji ZRRU :

1. Nait Hasani,
 2. Sali Morina
- Do të ftohen eksperti dhe zyrtari i ZRRU.

GP.2. P/Ligji Planifikim Hapesinor :

Komisioni

GP.3. P/Ligji per trajtimin e ndertimeve pa leje :

Komisioni

GP4. P/Ligji per Inspektoriatin :

1. Nait Hasani,
2. Daut Haradinaj,
3. Sali Morina.

GP5. Monitorimi i Ligjit per Ajrin :

1. Nait Hasani,
2. Rasim Demiri,
3. Boban Todoroviç.

GP.6. Monitorimi i Ligjit per Zhurmen :

1. Rasim Demiri,
2. Boban Todoroviç,
3. Nait Hasani.

GP.7. Monitorimi i Ligjit per Pyjet :

1. Nijazi Idrizi,
2. Liburn Aliu,
3. Sevdije Lama,
4. Sali Morina,
5. Boban Todorovic

GP.8. Monitorimi i Ligjit per Vererat:

1. Nait Hasani,

2. Daut Haradinaj,
3. Aferdita Berisha.

Komisioni shqyrtoi vërejtjet e Komisionit për Legjislacion rreth **Projektligjit për Ndërtesat në bashkëpronësi**, pasi që nuk ka pas gatishmëri nga ai komision për mbledhje të përbashkët me arsyetim se komisioni funksional duhet të sqarohet për ato vërejtje, ndaj **Kryetari Nait Hasani** lexoi në tërësi Rekomandimin e komisionit për legjislacion me çka u konstatua se këto vërejtje duhet të shqyrtohen në mbledhjen e radhës bashkërisht me MMPH ngase duhet të verifikohet a janë këto vërejtje pengesa serioze të cilat do të bllokojnë zbatimin e Ligjit pas hyrjes në fuqi.

Komisioni konstatoi se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës janë plotësuar kushtet ligjore për përmbushjen e obligimit për zgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë, ndaj nxori :

V E N D I M

1. Të shpallet konkursi publik për pozitën e Drejtorit të Agjencisë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës,
2. Ngarkohet Drejtoria për Personel i Kuvendit të Republikës së Kosovës për procedimin e mëtejme të këtij vendimi të Komisionit parlamentar.

Komisioni u ftua të prezantoi në vizitën e së hënës në Prizren.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani